



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 15337 Prot

Vlorë, më 25.09 2025

Lënda: Njoftim për mbledhjen jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë, datë 29.09.2025.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE
PREFEKTIT TË QARKUT VLORE**

Ju njoftoj se, **ditën e hënë, datë 29.09.2025, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhje jashtë radhe e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 4, ku pas ;

1. Shprehje për ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr 78, datë 22.09.2025.

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim “Për një rishpërndarje të fondeve në VKB Nr 111, datë 27.12.2025 “Për Buxhetin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2025”, i ndryshuar.

Kryesia e Këshillit të Bashkisë, u mbledh në mjediset e Bashkisë Vlorë, ditën e enjte, datë 25.09.2025, ora 11:00.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e premte , datë 26.09.2025 , ora 09:00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e premte datë 26.09.2025, ora 09:45.

Komisioni i shërbimeve publike , transportit, infrastrukturës dhe strehimit, do të mbledhet ditën e premte, datë 26.09.2025, ora 10:30.

Komisioni për zhvillimin urbanistik dhe ndërtimet, do të mbledhet ditën e premte, datë 26.09.2025 , ora 11:30.

Komisioni për arsimin, kulturën dhe sportet , do të mbledhet ditën e premte, datë 26.09.2025, ora 12:30.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 15556 Prot.

Vlorë, më 25 . 09 . 2025

VENDIM

Nr 11, datë 25.09.2025

**“MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN JASHTË
RADHE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 53, pika 3/a; Neni 56, pika 2 dhe, Rregulloren “Për Organizmin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” Neni 60, pikat 1/a , 2 dhe 3, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 25.09.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë Vlorë, e cila do të mbahet në datën 29.09.2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit dhe, në mungesë të tij, Kryetari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Vlorë, Deputetët e Bashkisë Vlorë dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te Kryetari i Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

